



Datë: 21.03.2025
Numër Protokolli: 1908/2025

A.nr. 119/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka–në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.119/2025 të datës 17.01.2025 të parashtruar nga ankuesi F.XH, kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.03.2025 mori:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.119/2025, e datës 17.01.2025 e parashtruar nga ankuesi F.XH, ashtu që **Anulohet** Lista e rezultateve përfundimtare me numër protokolli 512, e datës 20.12.2024, e publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, lidhur me konkursin e brendshëm për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë si dhe procedura e vlerësimit në testimin me shkrim dhe intervista me gojë.

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke ndërmarr veprimet të themeloj komisionin për procesin e gradimit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, në mënyrë që procedura sipas konkursit të zhvillohet nga faza e shqyrtimit të aplikacioneve.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

Ar sy e t i m

Ankuesi F.XH, (*tutje referuar vetëm* ankuesi), me datë 17.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 330/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër konkursit të brendshëm për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë për shkak të shkeljeve esenciale procedurale vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pretendon se Komisioni vlerësues është themeluar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues pasi që Kryesuesi dhe njëri anëtar i komisionit duhet të kenë së paku një (1) gradë më të lartë se grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit ndërsa anëtari i tretë duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, kjo përbërje është në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 3 thekson se nuk kishte një vlerësim real në të dyja testet me shkrim dhe intervistë dhe se moskalueshmëria ime ka ardhë si rezultat i diskriminimit politik, propozon që të vërtetohet drejt dhe saktë gjendjen faktike të poentimit dhe të anulohet konkursi për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 03.02.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues të Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 27.02.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 330/2025 të datës 17.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs i brendshëm për pozitën Mbikëqyrës i lart në Qendrën e paraburgimit Prishtinë me referencë MD/SHKK/13 i datës 26.08.2024; Lista e rezultateve preliminare rezultateve të testimit me shkrim me numër protokolli 466 i datës 02.12.2024; Lista e rezultateve përfundimtare e intervistës me gojë me numër protokolli 501 i datës 19.12.2024; Lista e rezultateve përfundimtare të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë me numër protokolli 512 i datës 20.12.2024; Letërnjoftim i F.Xh.; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 31.01.2025; Përgjigje në ankesë i datës 03.02.2025; Lista e rezultateve preliminare rezultateve të testimit me shkrim me numër protokolli 476 i datës 10.12.2024; Vendim për emërim të komisionit të pranimit me numër protokolli 991 i datës 21.10.2024; Lista e kandidatëve që i plotësojnë kushtet dhe kriteret me numër protokolli 428 i datës 14.11.2024; Vlerësimi i intervistës me gojë të kandidatëve nga anëtari i komisionit P.R. për pozitën Mbikëqyrës i lart; Vlerësimi i intervistës me gojë të kandidatëve nga kryesuesi i komisionit A.K. për pozitën Mbikëqyrës i lart; Vlerësimi i intervistës me gojë të kandidatëve nga anëtari i komisionit V.N. për pozitën Mbikëqyrës i lart; Kërkesa

për punësim e F.Xh. i datës 04.09.2024; Kontratë punë për kohë të pacaktuar e F.Xh. i datës 15.07.2020; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina e F.Xh. me numër nr.6906 i datës 05.02.2020; Diplomë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike për F.Xh. me numër nr.72 i datës 05.07.2022; Certifikatë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike për F.Xh. i datës 17.09.2021; Certifikatë mbi dënimet penale e F.Xh. i datës 03.09.2024; Vërtetim nga MPB/PK për F.Xh. i datës 03.09.2024; Vlerësimi i rezultateve në punë i F.Xh. i datës 05.01.2024; Vlerësimi i rezultateve në punë i F.Xh. i datës 26.01.2023; Vërtetim nga udhëheqësi i personelit qendra e paraburgimit prishtinë për F.Xh. i datës 04.09.2024; Kërkesa për punësim e B.D. i datës 10.09.2024; Diplomë nga Kolegji Fama për B.D. me numër nr.218/0518 i datës 21.05.2018; Vërtetim nga MPB/PK për B.D. i datës 29.08.2024; Certifikatë mbi dënimet penale e B.D. i datës 29.08.2024; Letërnjoftim i B.D.; Vërtetim nga Udhëheqësi i Administratës Qendra e paraburgimit Prishtinë në SHKK për B.D. i datës 05.09.2024; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e B.D. i datës 15.07.2020; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 i B.D.; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2023 i B.D. i datës 07.01.2023; Kërkesa për punësim e F.I. i datës 09.09.2024; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e F.I. i datës 30.06.2018; Diplomë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike për F.I. me numër nr.26 i datës 10.10.2019; Certifikatë mbi dënimet penale e F.I. i datës 06.09.2024; Vërtetim nga MPB/PK për F.I. i datës 29.08.2024; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2023 i F.I. i datës 03.01.2024; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 i F.I. i datës 24.01.2023; Letërnjoftim i F.I.; Vërtetim nga Udhëheqësi i Administratës Qendra e paraburgimit Prishtinë në SHKK për F.I. i datës 06.09.2024; Vërtetim nga personeli i SHKK për F.I. i datës 02.07.2024; Certifikatë nga Unmik për F.I. i datës 04.06.2004; Certifikatë nga AKSP për F.I. i datës 14.09.2018; Certifikatë nga AKSP për F.I. i datës 26.02.2021; Certifikatë nga AKSP për F.I. i datës 07.10.2021; Kërkesa për punësim e V.K. i datës 06.09.2024; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e V.K. i datës 15.07.2020; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës fakulteti ekonomik për V.N. me numër nr.20/399 i datës 19.12.2007; Certifikatë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike për V.K. me numër nr.158 i datës 04.04.2024; Certifikatë mbi dënimet penale e V.K. i datës 03.09.2024; Vërtetim nga MPB/PK për V.K. i datës 04.09.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për stafin korrektues viti 2023 për V.K. i datës 16.01.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për stafin korrektues viti 2022 për V.K. i datës 28.12.2022; Letërnjoftim i V.K.; Vërtetim nga personeli i SHKK për V.K.N. i datës 22.08.2024; Vendim nga zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK për V.K. i datës 20.10.2022; Certifikatë nga shkolla e gjuhëve të huaja zoom school për V.K. i datës 20.06.2023; Certifikatë nga AKSP për V.N. i datës 25.10.2013; Certifikatë nga icitap për V.K. i datës 08.02.2023; Certifikatë nga icitap për V.K. i datës 30.05.2024; Certifikatë nga icitap për V.K. i datës 01.12.2023; Certifikatë nga bds për V.K. i datës 05.11.2021; Certifikatë nga AKSP për V.K. i datës 24.03.2022; Certifikatë nga bds për V.K. i datës 24.06.2022; Certifikatë nga icitap për V.K. e muajit Tetor 2022; Certifikatë nga Eu për V.K. i datës 11.02.2022; Certifikatë e V.K. i datës 18.03.2022; Certifikatë nga icitap për V.K. i datës 01.07.2021; Certifikatë nga Icmtc për V.K. e muajit Maj 2019; Certifikatë nga AKSP për V.K. i datës 25.09.2020; Certifikatë nga Cda për V.K. i datës 23.07.2018; Certifikatë nga AKSP për V.K. i datës 31.03.2017; Certifikatë nga icitap për V.K. i datës 11.08.2017; Certifikatë nga Eulex për V.N. i datës 29.05.2018; Testi me shkrim i B.D. i datës 21.11.2024; Testi me shkrim i F.Xh. i datës 21.11.2024; Testi me shkrim i V.K. i datës 21.11.2024; Testi me shkrim i F.I. i datës 21.11.2024; Akt Emërim i A.K. i datës 07.12.2023; Akt Emërim i P.R. i datës 27.12.2022;

Akt Emërim i V.N. i datës 06.05.2019; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 1307/2025 i datës 27.02.2025;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse**:

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 26.08.2024 ka shpallur konkursin e brendshëm me numër reference MD/SHKK/13-26.08.2024 me numër protokolli 304 për pozitën Mbikëqyrës i Lartë tri (3) pozita, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Tutje sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar njëzetë (20) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili i është nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ndërsa pas përfundimit të procesit të rekrutimit më datë 20.12.2024 është publikuar lista e rezultateve përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistë me gojë me numër protokolli 512, ku sipas kësaj liste kanë rezultuar tre kandidatë me më së shumti pikë, F.I. me gjithsejtë 92.5 pikë, V.K. me gjithsejtë 86.3 pikë, B.D. me gjithsejtë 79.8 pikë dhe ankuesi me gjithsejtë 73 pikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër konkursit të brendshëm për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë për shkak të shkeljeve esenciale procedurale vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pretendon se Komisioni vlerësues është themeluar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues pasi që Kryesusi dhe njëri anëtar i komisionit duhet të kenë së paku një (1) gradë më të lartë se grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit ndërsa anëtari i tretë duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, kjo përbërje është në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 3 thekson se nuk kishte një vlerësim real në të dyja testet me shkrim dhe intervistë dhe se moskalueshmëria ime ka ardhë si rezultat i diskriminimit politik, propozon që të vërtetohet drejt dhe saktë gjendjen faktike të poentimit dhe të anulohet konkursi për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë.

Në kuptim të vendosjes lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkritazi me nëpunësit me status të veçantë, gjegjësisht nenit 6 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: **“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; 1.3. zyrtarët/ët e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror, që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror; 1.4. anëtarët/ët e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike; 1.5. të punësuarat/it në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjenci të saj; 1.6. të punësuarat/it në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencitë e saj, përjashtimisht Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës; 1.7. të punësuarat/it në Administratën Tatimore të Kosovës; 1.8. të punësuarat/it në Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së**

Pajustificueshme. 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin.

Duke u bazuar në atë se të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil me status të veçantë, Kolegji i Këshillit, ju referua Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, duke konstatuar se konkursi i brendshëm për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, është hapur në pajtim me nenit 7 të këtij udhëzimi, ngase në këtë rast kemi të bëjmë me avancimin në grada, ndërsa kriteret për gradën Mbikëqyrës i Lartë sipas konkursit janë të përcaktuara konform nenit 9 të këtij udhëzimi.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komisioni vlerësues është themeluar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues pasi që Kryesuesi dhe njëri anëtar i komisionit duhet të kenë së paku një (1) gradë më të lartë së grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, ndërsa anëtari i tretë duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, dhe ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokolli 991 të datës 21.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është emëruar komisioni përzgjedhës për procesin e gradimit për pozitën Mbikëqyrës dhe Mbikëqyrës i Lartë në përbërje: *A.K.-Menaxher i Burimeve Njerëzore DP-Kryesues; P.R.-Udhëheqës për Punë Juridike dhe të Përgjithshme-Anëtar dhe V.N.-Koordinator për Staf në SHKK-Anëtar.*

Duke marr parasysh që procedura e konkursit të brendshëm është përmes sistemit të gradave Kolegji i Këshillit, konstaton se sistemi i gradave është i paraparë sipas nenit 53 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, i cili përcakton se: *1. Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat vijuese: 1.1. kadet për zyrtar korrektues; 1.2. zyrtar korrektues; 1.3. mbikëqyrës; 1.4. mbikëqyrës i Lartë; 1.5. udhëheqës i Njesisë. 2. Procedura dhe kushtet për gradim të zyrtarëve korrektues rregullohet me aktin e nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë, ndërsa sistemi i njëjtë i gradave është paraparë edhe sipas nenit 3 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, është përcaktuar: 1.Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat si në vijim: 1.1. Kadet për Zyrtar Korrektues; 1.2. Zyrtar Korrektues; 1.3. Mbikëqyrës; 1.4. Mbikëqyrës i Lartë; 1.5. Udhëheqës i Njesisë.* Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, marr për bazë sistemin e gradave në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës të përcaktuar me dispozitat e cekura si më lartë, vlerëson se komisioni për procesin e gradimit, duhet të jetë i themeluar përmes sistemit të gradave, me përjashtim të anëtarit të Njesisë së Burimeve Njerëzore, e si rezultat i kësaj, marr për bazë edhe kriteret ligjore për themelimin e komisionit për procesin e gradimit, Kolegji vlerëson se komisioni i themeluar sipas Vendimit me numër protokolli 991 të datës 21.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, nuk është në harmoni

të plotë me dispozitat e nenit 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, e ku përcaktohet: “2.Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë nga zyrtarët e Shërbimit Korrektues. 3.Kryesuesi dhe njëri anëtarë i Komisionit duhet të ketë së paku një (1) gradë më të lartë se grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit. Anëtar i tretë i Komisionit duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore”, ngase asnjëri nga anëtarët e komisionit nuk mban pozitë sipas sistemit të gradave, për rrjedhojë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Përkitazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, dhe konstatimeve të dhëna si në vendim, vlerëson se ankesa e ankuesit është e bazuar, kështu që ka vendosur të anulohet listën e rezultateve përfundimtare me numër protokolli 512, të datës 20.12.2024, lidhur me konkursin e brendshëm për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë, dhe të obligoj Drejtorinë e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore të themelojë komisionin për procesin e gradimit, në pajtim me dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, në mënyrë që procedura sipas konkursit të zhvillohet nga faza e shqyrtimit të aplikacioneve.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.119/2025, datë 21/03/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.XH;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Numri i lëndës: A.nr.119/2025
Datë: 21.03.2025
Numër Protokolli: 1908/2025